



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 7518 / datë 23/11/2016
/3

PËR

“CAKTIMIN E DATËS SË KONKURIMIT, KRITERET DHE PROCEDURËN E ORGANIZIMIT DHE SHPALLJES SË REZULTATEVE TË PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT PËR MARRJEN E LEJES SË USHTRIMIT TE PROFESIONIT TË NOTERIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, si dhe të nenit 3, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, "Për noterinë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

Dhoma Kombëtare e Noterisë të ndjekë procedurat e përcaktuara si më poshtë;

1. Provimi i kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, për vendet vakante në njësitë e qeverisjes vendore, të shpallura dhe njoftuara publikisht në "Fletoren Zyrtare" nr. 222, datë 18.11.2016, me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 7518/2, datë 16.11.2016, "Për caktimin e numrit të përgjithshëm të noterëve dhe numrit të tyre për çdo rreth gjyqësor, si dhe mbulimin përkatës për çdo bashki, së bashku me njësitë administrative pranë saj", të organizohet nga Dhoma Kombëtare e Noterisë në datën 18.12.2016, ora 09:00, në mjediset e Ministrisë së Drejtësisë.
2. Provimi i kualifikimit të zhvillohet për plotësimin e vendeve vakante për noterë, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Dhoma Kombëtare e Noterisë cakton Administratorët e Provimit dhe anëtarët e Komisionit të Kualifikimit të Provimit.
4. Dhoma Kombëtare e Noterisë cakton anëtarët e Komisionit të Hartimit të Tezës. Teza e provimit mbështetet në programin e përcaktuar në Aneksin 2 bashkëlidhur këtij urdhri.
5. Dhoma Kombëtare e Noterisë cakton anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit për noter.
6. Çdo kërkesë për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit për noter depozitohet pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës, që provon se kandidati përmbush kushtet për t'u bërë noter, sipas nenit 2, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, "Për noterinë", i ndryshuar, si dhe me dokumentin që provon pagimin e tarifës së provimit.
7. Kopja e këtij urdhri publikohet në faqen zyrtare në internet të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në faqen zyrtare në internet të Dhomës Kombëtare të Noterëve..
8. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

YLLI MANJANI



ANEKSI NR. 1

VENDET VAKANTE PËR ÇDO NJËSI TË QEVERISJES VENDORE

BASHKIA/NJËSI ADMINISTRATIVE NUMRI I VENDET VAKANTE

Durrës	2
Golem	1
Elbasan	1
Peqin	1
Belësh	1
Përrenjas	1
Fier	1
Pogradeci	1
Kavajë	2
Rrogozhinë	1
Vlorë	1
Gjirokastër	1
Delvina	1
Korçë	1
Lezhë	2
Shëngjin	1
Rrëshen	1
Berat	1
Shkodër	1
TOTAL	22

ANEKSI NR. 2

Provimi i kualitikimit për noter do të bazohet në njohuritë:

1. Të drejtes Kushtetuese.
2. Të drejtes Civile dhe Tregtare.
3. Procedures Civile.
4. Procedures Penale.
5. Të drejtës Administrative.
6. Të drejtës Familjare.
- 7- Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për noterine", i ndryshuar, së bashku me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
7. Ligjit nr. 8537, 18.10.1999 "Për barrat siguruese dhe kolateralin", i ndryshuar.
8. Kuadri ligjor për pastrimin, parandalimin dhe financimin e terrorizimit.
9. Ligjit Nr.8901, date 23.05.2002 "Për falimentin", i ndryshuar.
10. Ligjit nr. 33/2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluejtshme".